

PLANI I INTEGRITETIT I MINISTRISË SË BRENDSHME 2022-2024



www.mb.gov.al

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të konsolidimit të institucioneve publike, përmes reformave të rëndësishme, thellimit të luftës kundër korrupsionit, përzgjedhjes dhe trajnimit të punonjësve të administratës publike dhe një numri të konsiderueshëm masash të tjera, Nga ana tjetër, mbetet shumë për të bërë për të shmangur çdo mundësi për abuzim dhe për të rritur besimin e qytetarëve tek institucionet shtetërore.

Rëndësia e këtij plani integriteti qëndron, së pari, në përpjekjen tonë të vazhdueshme për të konsideruar integritetin, etikën dhe transparencën si vlera themelore që i shërbejnë mirëfunksionimit institucional të Ministrisë së Brendshme si dhe tek efektet dhe ndikimi i drejtëpërdrejtë që kanë masat e tij në forcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Brendshme 2022-2024 është një copë e mozaikut që plotëson kuadrin institucional kundër korrupsionit dhe do të shërbejë si instrument i rëndësishëm për identifikimin dhe parandalimin e risqeve ndaj korrupsionit dhe cënimit të integritetit në fushat e përgjegjësisë më të ekspozuara. Dokumenti reflekton qasjen se si mund të kuptohet, zhvillohet dhe jetësohet ndërtimi i integritetit në strukturat dhe institucionet e Ministrisë së Brendshme por edhe përcakton mënyra dhe mekanizma efektive për një gjë të tillë.

Megjithëse përballja me impaktin negativ të korrupsionit dhe me perceptimin e tij është një sfidë e vazhdueshme, Ministria e Brendshme do të vijojë përpjekjet e saj për të rritur proaktivitetin dhe bashkëpunimin ndër-institucional me qëllim garantimin e shërbimeve cilësore, të paanshme dhe transparente ndaj komunitetit si dhe promovimin e vazhdueshëm të një kulture pune në administratën publike bazuar në këto vlera.

Zbatimi i plotë i Planit të Integritetit do ta çojë administratën e Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të saj një hap më pranë përmbushjes së atyre standardeve që dëshirojmë të gjithë.

Bledar Çuçi

Ministër i Brendshëm

PËRMBAJTJA

Deklarata e Integritetit.....	2
Lista e shkurtimeve.....	4
I. Hyrje.....	5
II. Qëllimi i dokumentit.....	10
III. Mbi metodologjinë dhe procesin.....	11
IV. Objektivat dhe parimet.....	14
V. Risqe të lidhura me integritetin, të identifikuara në strukturat dhe institucionet e Ministrisë së Brendshme.....	16
1. Risqe në fushën e Prokurimit Publik.....	16
2. Risqe në fushën e inspektimeve, kontrolleve, lëshimit të licensave dhe certifikimeve....	19
3. Risqe në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.....	20
4. Risqe në fushën e menaxhimit financiar, asetëve, projekteve dhe shërbimeve.....	22
5. Risqe në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit.....	24
6. Risqe në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët apo shërbimeve të tjera.....	25
7. Risqe që lidhen me cënimin e etikës, paanshmërinë, dinjitetit, mbrojtjen e reputacionit dhe imazhit të institucionit.....	26
VI. Zbatimi, raportimi dhe monitorimi.....	27
VII. Konkluzione dhe rekomandime.....	28
Aneks 1: Plani i Veprimit për jetësimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme 2022-2024	

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ABP	- Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
AMVV	- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASPA	- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AB	- Auditi i Brendshëm
DAS	- Drejtoria e Arkivit të Sistemit
DAP	- Departamenti i Administratës Publike
DPPÇVP	- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat
DPESHM	- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse
DPGJC	- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
DSIK	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
GR	- Garda e Republikës
GP	- Grupi i Punës
IKMT	- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ILDKPKI	- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
MB	- Ministria e Brendshme
MZSH	- Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
PI	- Plani i Integritetit
QKPA	- Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit
SHÇBA	- Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
SHPMB	- Shtëpia e Pushimit të Ministrisë së Brendshme
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave

I. HYRJE

Integriteti është themel i çdo sistemi të mirëqeverisjes, ashtu sikurse dhe një nga parimet themelore të sjelljes në institucionet shtetërore, krahas besueshmërisë, ndershmërisë, transparencës, objektivitetit dhe bashkëpunimit. Rritja e nivelit të integritetit në institucionet shqiptare qëndrore dhe vendore është një kusht i domosdoshëm për ndërtimin e një administrate publike të konsoliduar dhe efektive.

Çështjet e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit në institucionet e administratës publike, marrin një rëndësi të veçantë edhe në tërësinë e përpjekjeve dhe masave për përmbushjen e standardeve e detyrimeve që ka vendi në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Shqipëria ka bërë progres në luftën ndaj korrupsionit, duke përmirësuar vazhdimisht pozicionin dhe renditjen e saj sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (CPI)¹, por institucionet shqiptare publike kanë akoma shumë për të bërë në këtë drejtim. Promovimi, ndërtimi dhe garantimi i vazhdueshëm i integritetit në Ministrinë e Brendshme dhe në institucionet e saj përmes planeve strategjike dhe mekanizmave të duhur, është një nevojë dhe detyrim dhe për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut tek ato.

Shkaqet dhe pasojat e lidhura me risqet e korrupsionit dhe integritetit janë shumëdimensionale duke përfshirë një gamë të gjerë, që prek si sferën personale ashtu dhe atë institucionale, por dhe të gjitha nivelet e hierarkisë. I kuptuar si abuzim i pushtetit të dhënë për përfitime private², korrupsioni mund të marrë forma e dimensione nga më të ndryshmet.

Nga ana tjetër, impakti i korrupsionit mund të jetë i jashtëzakonshëm për stabilitetin e vendit, pasi ai gërryen dhe dobëson tre shtylla të rëndësishme mbi të cilat ai mbahet: sigurinë, politikën dhe ekonominë. Në këtë këndvështrim, lufta ndaj korrupsionit merr një rëndësi të veçantë për institucionin tonë dhe për çdo punonjës të administratës. Situatat dinamike dhe komplekse të sigurisë që përfshijnë trafiqet, krimin e organizuar, por dhe situatat e paqëndrueshmërisë politike, katastrofat natyrore, pandemitë, etj., krijojnë mundësi të shtuara për korrupsion dhe abuzim. Për këtë arsye, konsolidimi i mekanizmave parandalues dhe mbikëqyrës për çdo situatë dhe për çdo aspekt veprimtarie është i domosdoshëm.

Koncepti i integritetit është vlerësuar më gjerësisht dhe përfshin në vetvete jo vetëm ndershmërinë dhe mungesën e korrupsionit, por dhe një sërë aspektesh të tjera që përbëjnë menaxhimin publik, të tilla si etika, sjella dhe komunikimi profesional, standardet, vlerat, konfidencialiteti, transparenca, paanshmëria dhe llogaridhënia, garantimi i të cilave krijon një barrierë mbrojtëse ndaj korrupsionit.

¹ <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/alb#>

² <https://www.transparency.org/en/what-is-corruption>

Në mënyrë të veçantë njohja dhe vlerësimi i thelluar i risqeve të korrupsionit në institucionet e sigurisë publike dhe ato ligjzbatuese, konsiderohet edhe më thelbësore për të ndërtuar qasjen e duhur kundër tij dhe për t'ua luftuar në mënyrë efektive nëpërmjet politikave konkrete parandaluese e proaktive, konsolidimit të proceseve dhe rritjes së profesionalizmit dhe integritetit.

Në këtë kuadër, është përgatitur Plani i Integritetit të Ministrisë së Brendshme, si një dokument strategjik dhe mekanizëm efektiv për menaxhimin e risqeve potenciale të integritetit në fushat e përgjegjësisë shtetërore të ngarkuara:

- Rendi dhe siguria publike;
- Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore;
- Menaxhimi i integruar i kufirit dhe migracionit;
- Azili dhe shtetësia;
- Antiterrori dhe ekstremizmi i dhunshëm;
- Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi
- Veprimtaria e prefektit të qarkut;
- Bashkërendimi dhe koordinimi i mbështetjes së njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;
- Shërbimet e gjendjes civile;
- Hartimi i politikave, koordinimi dhe mbikëqyrja e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri;
- Veprimtaria e organit qendror të blerjeve të përqendruara;
- Parandalimi, mbrojtja, mbikëqyrja dhe kontrolli e inspektimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

Ministria e Brendshme synon të garantojë një mjedis sa më të sigurtë për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë përmes forcimit të rendit dhe sigurisë publike, ofrimit të shërbimeve cilësore dhe mbrojtjes së territorit me struktura profesionale e me integritet që veprojnë në përputhje të plotë me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve, duke i shërbyer me përkushtim dhe profesionalizëm interesit publik dhe përmbushur angazhimet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të vendit.

Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë, në veprimtarinë e tyre, janë subjekt i monitorimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit nga një sërë mekanizmash ligjorë si Kontrolli i Lartë i Shtetit (si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar për pushtetin qendror dhe vendor), Auditi i Brendshëm, Avokati i Popullit, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) i cili është institucioni përgjegjës në hetimin administrativ të sinjalizimeve sipas ligjit *Nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga i cili është miratuar Programi

Transparencës. Ky program përbën detyrim për secilin autoritet publik për të publikuar informacion sipas veprimtarisë së tij funksionale si dhe për ta rishikuar e përditësuar atë në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.

Ministria e Brendshme është e angazhuar me masa dhe aktivitete në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Planit të Veprimit 2020-2023, dhe është pjesë përbërëse e Komitetit Koordinator Kundër Korrupsionit, përgjegjës për zbatimin e politikave dhe objektivave të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Gjithashtu, në këtë kuadër funksionon edhe Komiteti Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Evazionit për hartimin dhe miratimin e kuadrit politikëbërës strategjik në fushën antikorrupsion, si dhe Task Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 106, datë 25.7.2019, *“Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion”*, u ngrit Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion, si një strukturë e shtrirë në nivel qendror dhe lokal. Ky mekanizëm u sanksionua më tej me nxjerrjen e VKM nr. 618, datë 20.10.2021, *“Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit”*. Rrjeti i Koordinatorëve ka në përbërje, në rolin e koordinatorit, përfaqësues nga institucione në nivel qendror e në nivel rajonal, duke u shtrirë kështu edhe në institucionet e Ministrisë së Brendshme si Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara; Agjencia e Blerjeve të Përqendruara; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit.

Në kuadër të garantimit të integritet, ligjshmërisë dhe luftës së vazhdueshme kundër korrupsionit, Ministria e Brendshme mbikëqyr institucionet dhe aparatën e saj dhe përmes strukturave të saj, në mënyrë të veçantë Auditit të Brendshëm dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. SHÇBA ka për mision garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të Strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada. Shërbimi mbikëqyr dhe kontrollon strukturat e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit Zjarrfikës, nëpërmjet:

- marrjes dhe shqyrtimit të ankesave të ardhura nga publiku për punonjës të Strukturave, që nga sjelljet jo etike e deri tek shkeljet e ligjit;
- kryerjes së inspektimeve ndaj Strukturave për performancën e tyre në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara;
- hetimit të veprave penale të kryera nga punonjësit e Strukturave si dhe shkeljeve të tjera të ligjit;
- kryerjes së testit të integritetit për punonjësit e Strukturave;
- kontrollit të pasurisë së pajustificuar të punonjësve të Strukturave mbi bazën e ankesave dhe kallëzimeve;
- si dhe kryerjes së analizave – studimeve dhe rekomandime.

Vitet e fundit treguesit e performancës tregojnë për vullnet dhe angazhim të plotë në luftën kundër korrupsionit dhe paligjshmërisë si dhe rritje të besimit të publikut në institucionet e sigurisë së Ministrisë së Brendshme. Gjatë vitit 2020, SHÇBA ka proceduar 317 subjekte dhe ka arrestuar/ndaluar 84 persona. Ndër ta: 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues, 98 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 208 punonjës policie të nivelit zbatues, 1 punonjës civil, 5 efektivë të Gardës së Republikës dhe 4 punonjës të PMNZSH. Rritje në vitet e fundit kanë shënuar dhe thirrjet nga publiku në numrin e gjelbër, ndërsa numri i ankesave të depozituara pranë SHÇBA ka shënuar një trend zbritës.

Një mekanizëm kontrolli e vlerësimi i një rëndësie të veçantë konsiderohet dhe procesi i vettingut në institucionet e Ministrisë së Brendshme. Nga ligji nr.12/2018, datë 5.3.2018, “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar u krijua Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (KJV) si organi i posaçëm për kryerjen e procesit të vlerësimit. Procesi ka për objekt vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Shtesat dhe ndryshimet ligjore të vitit 2020 parashikojnë zhvillimin e procesit të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve, nga ana e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesa paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit. Nga fillimi i procesit, deri në nëntor të 2021 ka përfunduar procesi i vlerësimit kalimtar për 53 subjekte nga të cilët 28 nga Policia e Shtetit, 23 nga SHÇBA dhe 2 nga Garda e Republikës.

Pëmes procesit të Vettingut synohet forcimi i besimit të publikut, garantimi dhe promovimi i integritetit dhe rritja e standardeve dhe aftësive profesionale të punonjësve që punojnë në këto institucione të rëndësishme të rendit dhe sigurisë publike.

Plani i Integritetit i Ministrisë së Brendshme është një instrument që garanton përgjegjshmëri më të mirë të autoritetit publik, hartuar në përmbushje të:

- Dispozitive ligjore e nënligjore në fuqi, sipas fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme, përcaktuar me Vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”;
- Objektivave A.8 “*Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion*” dhe A.9 “*Forcimi i integritetit të nëpunësve publik*”, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe në Planin e Veprimit 2021-2023³ dhe të *Pasaportës së Indikatorëve*”;
- Rekomandimeve të Raundit të Pestë të Vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit⁴ (The Group of States Against Corruption/GRECO), për miratimin dhe zbatimin e planeve konkrete të

³ https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-PLANI-I-VEPRIMIT-ANTIKORRUPSION-2020-2023_AL.pdf

⁴ <https://rm.coe.int/raundi-i-pesti-i-vleresimit-parandalimi-i-korrupsionit-dhe-promovimi-i/1680a0923c>

integritetit nga të gjitha ministrinë, të cilat të përmbajnë një analizë sistematike të riskut të lidhur me integritetin, me të cilin mund të përballen drejtuesit e lartë dhe këshilltarët politikë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe mekanizma të monitorimit dhe pajtueshmërisë etj.

Dokumenti është konceptuar në dy pjesë përbërëse: Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit për jetësimin e tij. Ai udhëhiqet nga një qasje holistike dhe reflekton disa karakteristika kryesore në konceptin e adresimit të zgjidhjeve për uljen e risqeve potenciale të korrupsionit dhe për rritjen e integritetit institucional, si:

- Dinamizmi;
- Fleksibiliteti;
- Përkohshmëria;
- Natyra parandaluese dhe proaktive;
- Ndërtimi dhe promovimi i vazhdueshëm i integritetit në strukturat dhe institucionet e Ministrisë së Brendshme.

Gjuha e dokumentit është e qartë dhe e drejtpërdrejtë duke synuar kuptimin, zbatimin dhe monitorimin lehtësisht dhe në mënyrë objektive të progresit.

II. QËLLIMI I DOKUMENTIT

Plani i Integritetit i Ministrisë së Brendshme është një dokument i nivelit strategjik me një natyrë operacionale, i cili ka si qëllim nga njëra anë të identifikojë risqet ndaj integritetit në strukturat dhe institucionet e varësisë dhe të vlerësojë nivelin e cënueshmërisë së tyre dhe nga ana tjetër të planifikojë masat e duhura për parandalimin dhe minimizimin e tyre.

Plani i Integritetit, i mbështetur në analizën e risqeve të lidhura me këtë aspekt në institucionet e Ministrisë së Brendshme, ka për qëllim identifikimin dhe vënien në funksion të mekanizmave për minimizimin e faktorëve që mund të lidhen me arsye, presione, raste apo mundësi të krijuara, e që shërbejnë si bazë për ekzistencën e korrupsionit, duke synuar në këtë mënyrë menaxhimin e risqeve dhe garantimin kurdoherë të shërbimeve cilësore, të paanshme e të përgjegjshme ndaj qytetarit.

Në këtë kontekst, ky dokument do të shërbejë si një mjet parandalues gjithëpërfshirës kundër korrupsionit, pasi synon promovimin dhe forcimin e integritetit duke përfshirë këtu integritetin individual, profesionalizimin, etikën, si dhe zbatimin e vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Në vazhden e përpjekjeve për të konsoliduar institucionin dhe mbrojtjen e tij nga cënimi i integritetit, ky dokument synon të luajë një rol kyç për:

- Menaxhimin e rrezikut të integritetit në të gjitha nivelet e Ministrisë së Brendshme;
- Menaxhimin e rrezikut të integritetit në të gjitha strukturat objekt të veprimtarisë së MB-së, me fokus në fushat dhe makro-proceset më të ekspozuara ndaj risqeve të korrupsionit;
- Angazhimin e strukturave drejtuese, zhvillimin e kapaciteteve, forcimin e mekanizmave mbikëqyrës, evidentimin e parandalimin e sjelljeve korruptive e abuzuese, rritjen e vetëdijes e kulturës nga të gjithë punonjësit, dekurajimin e “kulturës së heshtjes” dhe inkurajimin e denoncimit të veprimeve korruptive, diskriminuese dhe që shkelin etikën profesionale e institucionale.

Ndërtimi i integritetit përbën sfidë dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme, kuptim të thelluar të problemit dhe vullnet për të garantuar ndryshim në nivele të ndryshme, por sfida më e madhe lidhet me ndryshimin e mentalitetit dhe përvetësimin e kulturës së punës, për shkak dhe të nivelit të lartë rezistencës që haset në këtë drejtim.

III. MBI METODOLOGJINË DHE PROCESIN

Plani i Integritetit dhe Plani i tij i Veprimit vjen si rezultat i punës disamujore të përfaqësuesve dhe koordinatorëve të institucioneve dhe strukturave të Ministrisë së Brendshme, të mbështetur nga ekspertë të projektit PAMECA V dhe DCAF (Geneva Centre for Security Sector Governance).

Dokumenti u hartua në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 334, datë 07.10.2020 “*Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore*”⁵, dokument i cili i është referuar Standardeve ISO 31000 dhe 31010⁶, të përshtatura për analizën e riskut të integritetit, gjithashtu dhe duke shfrytëzuar metodat dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit për Ministrinë e Brendshme kaloi në disa faza.

Së pari, u ngrit grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme, i përbërë nga përfaqësues të strukturave dhe institucioneve të varësisë së MB. Ministria e Brendshme kërkoi edhe mbështetjen e ekspertëve të projektit PAMECA V dhe DCAF, të cilët kishin asistuar më parë edhe në procesin e hartimit të Planit të Integritetit të Policisë së Shtetit.

Së dyti, u hartua një plan pune, ku u përcaktuan afatet, masat dhe aktivitetet e planifikuara, me qëllim përgatitjen dhe përfundimin në kohë të Planit të Integritetit dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij.

Së treti, u zhvilluan takime të vazhdueshme të anëtarëve të grupit të punës, ku u diskutua mbi vijimësinë e procesit dhe detyrat e secilës strukturë.

Ekspertët e PAMECA V dhe DCAF, ofruan aktivisht ekspertizën e tyre, duke qenë pjesë e takimeve të Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit, si dhe nëpërmjet seminareve e trajnimeve që zhvilluan me anëtarët e GP, mbi metodologjinë e hartimit të analizës së riskut.

Grupi i Punës u angazhua për përgatitjen e një analize të thelluar të situatës dhe të bazuar në specifikat e strukturave të përfshira, duke shqyrtuar në mënyrë të hollësishme çdo aspekt dhe proces pune, çdo shërbim dhe produkt të ofruar. Ky proces përfshinte disa komponentë, si më poshtë:

1. Analizë e kuadrit ligjor sipas sektorëve lidhur me risqet në aspektin e ligjshmërisë, qartësisë, qëndrueshmërisë, mangësitë ligjore;

⁵ https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/3.-Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_AL.pdf

⁶ <https://www.iso.org/iso-31000-risk-management.html>

2. Analizë lidhur me organizimin e brendshëm, duke përfshirë strukturën organizative, shpeshhtësinë e ndryshimeve organizative, problematikat që dalin si rezultat i ndryshimeve strukturore;
3. Analizë e procesit të zinxhirit vendimmarrës, rekrutimi dhe procedurat e karrierës, prokurimet;
4. Identifikimi i burimeve dhe disponimi i të dhënave përkatëse përfshirë dhe të dhënat statistikore, posedimi dhe aksesimi në këto të dhëna, transparenca, pikat e forta dhe kufizimet e të dhënave, mbrojtja e të dhënave;
5. Identifikimi i fushave, aspekteve, proceseve, shërbimeve dhe strukturave më të ndjeshme dhe të ekspozuara ndaj korrupsionit si dhe arsyt e identifikimit të tyre;
6. Raste dhe fusha ku janë identifikuar ngjarje korruptive në të kaluarën, një studim i thelluar statistikor mbi rastet e kaluara, duke i kategorizuar këto raste në shkelje etike, thyerje disiplinore apo administrative dhe vepra penale;
7. Identifikimi i rekomandimeve kombëtare apo ndërkombëtare specifike për institucionin në këtë aspekt, nëse janë zbatuar apo aplikuar këto rekomandime.

Në vijim të hartimit të vlerësimeve për çdo strukturë dhe institucion varësie, informacionet u përpunuan dhe integruan në një dokument të vetëm. Identifikimi i risqeve u krye për të gjitha proceset dhe fusha të ndryshme si dhe për të gjitha nivelet, përfshirë edhe këshilltarë politikë, të vlerësuara si potencialisht të rriskuara apo të ekspozuara në drejtim të cënimit të integritetit të punonjësve dhe të institucionit. Risqet e identifikuara u konceptuan dhe kategorizuan në disa grupe e fusha të mëdha rrisht: në fushën e prokurimit publik; në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore; në fushën e menaxhimit financiar, të projekteve, aseteve dhe shërbimeve mbështetëse; në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit; në fushën e inspektimeve/kontrolleve dhe lëshimit të licensave e certifikimeve; në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët apo shërbimeve të tjera si dhe risqe të lidhura me shkeljen e etikës, paanshmërisë, cënimin e dinjitetit, reputacionit dhe imazhit të institucionit.

Në fund të procesit të analizës së fushave dhe proceseve të riskuara, u bë integrimi i tyre në një dokument komprehensiv “Matrica e Riskut të Integritetit në aparat, institucionet dhe strukturat e Ministrisë së Brendshme”. Ky dokument themelor shërbeu si baza kryesore për konceptimin dhe organizimin e Planit të Integritetit në institucion dhe për planifikimin e të gjitha masave në këtë drejtim. Mbi këtë bazë, grupi i punës vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme dhe Planit të Veprimit 2022-2024 në zbatim të tij.

Në këtë kuadër, vijuan takimet dhe me praninë e ekspertëve të PAMECA V dhe DCAF për identifikimin e masave e aktiviteteve të nevojshme realiste dhe me impakt, për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe të afateve, objektivave dhe indikatorëve përkatës.

Masat e planifikuara në këtë dokument kanë të bëjnë me përcaktimin më të qartë të përgjegjësiave të funksioneve, hartimin e politikave dhe akteve rregullatore, trajnimin dhe aftësimin e punonjësve si dhe me përmirësimin e mekanizmave të kontrollit nëpërmjet inspektimeve dhe mbikqyrjes më të drejtëpërdrejtë dhe raportimeve periodike.

Draftet përfundimtare të Planit të Integritetit dhe Plani i Veprimit, i'u nënshtruan procesit të konsultimit të brendshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë si dhe diskutimit me ekspertët e PAMECA V dhe DCAF, përpara miratimit të tyre.

Me miratimin dhe fillimin e implementimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme 2022-2024, procesi do të vijojë me hartimin e planeve të integritetit nga çdo institucion varësie i Ministrisë së Brendshme.

IV. OBJEKTIVAT DHE PARIMET

Përgatitja e dokumentit të Planit të Integritetit vlerësohet i një rëndësie të veçantë dhe që mbështet përpjekjet e drejtuesve të ministrisë së brendshme në luftën kundër korrupsionit dhe në konsolidimin e institucioneve në këtë drejtim. Ky dokument synon rritjen e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në strukturat e aparatit të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të saj të varësisë.

Plani i Integritetit është konceptuar i shtrirë në periudhën tre vjeçare 2022-2024 dhe synon realizimin e disa objektivave kryesore:

- Parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional;
- Rritjen e transparencës së institucioneve e strukturave të Ministrisë së Brendshme;
- Krijimin e mekanizmave monitorues mbi sjelljet që çënojnë integritetin;
- Përcaktimin e proceseve dhe rregullave të qarta për integritetin e nëpunësve të strukturave të Ministrisë së Brendshme;
- Forcimin e bashkëpunimit mes aktorëve të brendshëm në kuadër të përmbushjes së detyrimeve dhe objektivave strategjike në fushën e antikorrupsionit.

Fryma e përgjithshme e dokumentit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- **Parimi i ligjshmërisë**, sipas të cilit Ministria e Brendshme zbaton gjatë veprimtarisë së saj Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin në fuqi;
- **Parimi i unitetit dhe hierarkisë**, sipas të cilit Ministria e Brendshme organizohet në mënyrë të tillë që çdo drejtori apo institucion varësie, i raporton një organi apo institucioni epror;
- **Parimi i llogaridhënies**, sipas të cilit çdo nëpunës/punonjës i nënshtrohet drejtimin dhe mbikëqyrjes sipas organizimit të hierarkisë;
- **Parimi i efektivitetit**, sipas të cilit cdo nëpunës dhe strukturë organizohet në mënyrë që të realizojë me profesionalizëm dhe përkushtim detyrat e ngarkuara dhe objektivat e përcaktuar;
- **Parimi i paanshmërisë**, sipas të cilit çdo nëpunës që merr pjesë në një proces vendimmarrës administrativ, vepron në përputhje me rregullat e parandalimit të konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- **Parimi i transparencës**, si një parim bazë në veprimtarinë e administratës publike, për publikimin e informacionit procedural dhe përmbajtësor të shërbimeve publike në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë duke respektuar kufizimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë;
- **Parimi i konfidencialitetit**, ruajtja e informacionit si një detyrim që buron nga ligji dhe normat e etikës profesionale, por dhe një e drejtë;

- **Parimi i barazisë dhe i mos diskriminimit**, për të parandaluar çdo lloj forme të drejtpërdrejtë apo të tërthortë diskriminimi, cënimi të dinjitetit të personit dhe krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues, apo trajtimi të pabarabartë.
- **Parimi i decentralizimit**, përmes të cilit institucionet kanë përgjegjësinë e plotë për marrjen e masave të gjithanshme të cilat do të rezultojnë në konsolidimin e integritetit institucional si dhe të personelit të tyre.
- **Parimi i bashkëpunimit të brendshëm**, sipas të cilit çdo nëpunës bashkëpunon brenda njësisë organizative ku bën pjesë, si dhe me punonjësit e strukturave të tjera brenda Ministrisë, për përmbushjen e objektivave.

V. RISQE TË LIDHURA ME INTEGRITETIN TË IDENTIFIKUARA NË STRUKTURAT DHE INSTITUCIONET E MINISTRISË SË BRENDSHME

1. Risqe në fushën e Prokurimit Publik

Prokurimet janë një domosdoshmëri dhe një praktikë normale për kryerjen investimeve, lëvrimin të fondeve në nivel qendror, por edhe lokal. Nga analiza e zhvilluar, prokurimi publik është identifikuar një nga fushat me risk të lartë. Personat që punojnë në këtë sektor, përfshirë edhe drejtuesit, janë të riskuar në drejtim të cënimit të integritetit, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, për shkak të llojit të veprimtarisë, konkretisht në zhvillimin e procedurave të prokurimit të fondeve publike, në emër e për llogari të autoriteteve kontraktore.

Shqipëria, ka krijuar një traditë dhe ka fituar një përvojë në lidhje me prokurimet publike. Në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, ekzistojnë akte ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë këtë fushë dhe që përcaktojnë hapat dhe procedurat që duhen ndjekur, ku së fundmi është miratur ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili i ka filluar efektet që nga marsi i vitit 2021.

Megjithatë, edhe pse ekziston kuadri ligjor e rregullator në këtë fushë, jo rrallë herë ka munguar zbatimi me korrektësi e përgjegjësi i përcaktimeve të tij, duke mospërfunduar as përpjekjet për të ndikuar dhe orientuar prokurimet tek operatorë preferencialë. Në procedurat e prokurimeve, në fazat e ndryshme nga përzgjedhja tek blerja, risku vjen duke u rritur. Cdo prokurim duhet të nisë dhe të mbajë në fokus arsyen dhe rezultatin përfundimtar që kërkon të arrijë, duke iu përgjigjur pyetjes “Çfarë duam të përmirësojmë?” dhe jo “Çfarë duam të blejmë?”, duke u mbështetur në prioritetet dhe nevojat konkrete dhe reale.

Punonjësit e angazhuar në sektorët që merren me prokurimin publik dhe që kanë objekt të punës së tyre hartimin e dokumentave të tenderit, si përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, janë të riskuar në drejtim të:

- Konfliktit të interesave me kandidatë/operatorë ekonomikë të cilët mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit;
- Komunikimit të pajustificuar me kandidatë/operatorë ekonomikë të cilët mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit;
- Përcaktimit të kriterëve/kushteve të cilat mund të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën, në drejtim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të cilat në tërësinë e tyre, përveç cënimit të integritetit të punonjësve, mund të shkaktojnë edhe trajtim jo të barabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, ose mund të çenojnë besimin publik dhe transparencën në procedurat e prokurimit publik.

Punonjësit të cilët kanë objekt të punës së tyre, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, pra përcaktimin e arsyeve për skualifikim të ofertuesve, përcaktimin e ofertuesve të kualifikuar dhe të fituesve të prokurimit, janë të riskuar në drejtim të:

- Vlerësimi subjektiv/ të njëanshëm të ofertave;
- Nxjerrjes së informacionit apo dokumentacionit të klasifikuar si konfidencial nga ofertuesit;
- Konfliktit të interesit me ofertuesit;
- Komunikimit të pajustificuar me ofertuesit pjesëmarrës në procedurë, të cilat në tërësinë e tyre, përveç cënimit të integritetit të punonjësve, mund të shkaktojnë edhe trajtim jo të barabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, ose mund të çenojnë besimin publik dhe transparencën në procedurat e prokurimit publik.

Punonjësit të cilët kanë objekt të punës së tyre, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesat që paraqiten nga kandidatët / operatorët ekonomikë ose ofertuesit, si për kriteret/ kushtet e pjesëmarrjes ashtu edhe për vlerësimin e ofertave, pra vendimmarrjen nëse pretendimet e operatorëve ekonomik janë të bazuara dhe duhet të merren parasysh për të ndryshuar vendimmarrje të mëparshme, janë të riskuar në drejtim të:

- vlerësimi subjektiv/të njëanshëm të pretendimeve të parashtruara në ankesat e operatorëve ekonomikë në lidhje me procedurat e prokurimit;
- nxjerrjes së informacionit apo dokumentacionit të klasifikuar si konfidencial nga ofertuesit;
- qënies në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit;
- komunikimit të pajustificuar me ofertuesit pjesëmarrës në procedurë, të cilat në tërësinë e tyre, përveç cënimit të integritetit të punonjësve, mund të shkaktojnë edhe trajtim jo të barabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, ose mund të çenojnë besimin publik dhe transparencën në procedurat e prokurimit publik.

Kontrasti i cilësisë mbetet një hallkë delikate e procesit. Punonjësit të cilët kanë objekt të punës së tyre, monitorimin e zbatimit të kontratave që lidhen nga autoritetet kontraktore me ofertuesit fitues të procedurave të prokurimit që zhvillon ABP, janë të riskuar në drejtim të:

- Konfliktit të interesit me ofertuesit fitues që kanë lidhur kontratë me autoritetet kontraktore apo edhe me vetë punonjësit e autoriteteve kontraktore përgjegjës për zbatimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave;
- Vlerësimi subjektiv të njëanshëm nëse kontratat janë zbatuar me korrektësi, si nga kontraktuesit ashtu edhe nga autoritetet kontraktore në tërësinë e tyre.

Për blerjet/prokurimet me vlerë të vogël procedurat janë të ngjashme dhe ato janë adresuar me masa të posaçme në institucionet e varësisë që minimizojnë risqet e identifikuar në të gjitha fazat e prokurimit. Mosrespektimi i procedurave të prokurimit publik dhe mungesa e transparencës mund të çojë dhe në cënim të besimit të publikut tek ato dhe institucioni.

Nga sa më sipër, janë parashikuar të merren masat e mëposhtme:

- Plotësimi i deklaratës së konfliktit të interesit për çdo procedurë prokurimi, gjatë fazës së studimit të tregut dhe vlerësimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, nëpërmjet së cilës synohet ulja e rasteve të konfliktit të interesit.
- Kryerja e trajnimeve periodike dhe të detyrueshme për rritjen e nivelit profesional të punonjësve të angazhuar në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe mbi parandalimin e riskut në këtë fushë, ku synohet ulja e rasteve të denoncuarra për praktika të hartuara në mënyrë abuzive.
- Kufizimi i diskrecionit të titullarëve lidhur me qëndrueshmërinë e anëtarëve të komisionit, bazuar në kriteret e vlerësimit nga mekanizma të ndryshëm kontrolli, brenda dhe jashtë institucionit.
- Nënshkrimi i dhe respektimi i deklaratës së konfidencialitetit, si dhe hartimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i procedurave të prokurimit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet të cilave synohet ulja e rasteve të shkeljeve në procedurat e prokurimit publik.
- Zhvillimi i studimeve/analizave të tregut për produktet/shërbimet dhe standardet, me qëllim evidentimin e nevojave dhe marrjen në konsideratë të tyre në fazat e vlerësimit dhe përzgjedhjes e ofertës.
- Trajnimi i anëtarëve të komisionit lidhur me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore.
- Përmirësim i hartimit të specifikimeve teknike duke përfshirë ekspertizën e duhur në to, duke synuar realizimin e rekomandimeve të lëna auditimet e kryera.
- Ndarja e qartë e detyrave të anëtarëve të komisionit duke mos u përfshirë në procesin e hartimit të specifikimeve teknike, duke synuar prokurime në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike
- Identifikim dhe përcjellje specifikimeve nga strukturat kërkuese, në bashkëpunim me ekspertë të fushës.
- Respektimi i afateve ligjore për çdo fazë të procesit.

2. Riske në fushën e inspektimeve, kontrolleve, lëshimit të licensave dhe certifikimeve

Bazuar në fushën e përgjegjësisë të Ministrisë së Brendshme, struktura të veçanta të saj, në veprimtarinë e tyre të përditshme kryejnë inspektime apo kontrolle, si dhe japin leje apo licenca në fusha të caktuara.

Disa nga fushat me risk, me të cilët përballen inspektorët e kontrollit të mjedisit dhe territorit, të evidentuara në këtë aspekt janë:

- Hartimi dhe zbatimi i procedurave ndaj subjekteve kundërvajtës, jo në përputhje të plotë me parashikimet dhe afatet ligjore të trupës inspektuese, risk i cili mund të parandalohet duke përmirësuar kapacitetet e trupës inspektuese apo duke caktuar personat përgjegjës për identifikimin e kundravajtjes dhe marrja e masave përkatëse disiplinore.
- Inspektimi mbi baza preferenciale/selektive i trupës inspektuese ndaj subjekteve në fushën e kontrollit të territorit, ndërtimeve, mjedisit, ujrave dhe pyjeve.

Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të transparencës në fushën e kontrollit të territorit, ndërtimeve, mjedisit, ujrave dhe pyjeve rekomandohet: hartimi dhe miratimi i procedurave nga titullari për kryerjen e inspektimeve dhe respektimi i plotë i tyre, ku të parashikohen modeli, formulari, treguesit, afatet dhe frekuenca e inspektimeve; miratimi i formularëve të inspektimit me tregues konkret dhe të matshëm bazuar në standartet e kërkuara; shtimi i monitorimeve dhe kontrolleve nga strukturat e brendshme; aplikimi i sistemit online të inspektimit; hartimi dhe miratimi i planeve të inspektimit të përbashkëta e periodike me Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, duke synuar përmirësimin e kapaciteteve të trupës inspektuese, si dhe duke identifikuar personat përgjegjës për moszbatimin e saktë të procedurave dhe marrjen e masave përkatëse disiplinore ndaj tyre, synohet parandalimi i kryerjes së procedurave ndaj subjekteve kundërvajtës jo në përputhje të plotë me parashikimet dhe afatet ligjore, nga ana e trupës inspektuese.

Në kuadër të veprimarisë së tyre inspektuese punonjësit e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, përballen me risqe:

- të mosprocedimit të subjekteve të përfshira në aktivitet të kultivimit të bimëve narkotike
- të mospërcaktimit të përgjegjësive të subjekteve, gjatë inspektimit të strukturave.

Për të shmangur çdo rast abuzimi të mundshëm, është parashikuar rritja e kontrolleve dhe aktivitetit mbikëqyrës së strukturave përgjegjëse për konstatimin e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike, ndërtimi i ekipeve të integruara të inspektimit me përfaqësues të SHÇBA dhe të PSH dhe analizimi i rasteve të kultivimit të bimëve narkotike në të cilat janë përfshirë subjekte të SHÇBA.

Strukturat e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit përballen me disa risqe që çenojnë integritetin si individual ashtu dhe institucional si:

- Mungesa e inspektimeve/mungesa e procedimeve në vijim të inspektimeve të kryera në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor.
- Miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në kundërshtim me ligjin dhe certifikimi i objekteve/aktivëve nga strukturat e Shërbimit të MZSH-së jo në përputhje me kriteret ligjore.
- Dhënia e vërtetimit në kundërshtim me aktet nënligjore për rastet e zjarrit dhe Raportin e Ndërhyrjes.

Në lidhje me risqet e identifikuar, janë hartuar masat përkatëse në fushën e inspektimeve dhe lëshimit të licensave, kontrolleve e certifikimeve duke synuar përmirësimin e instrumenteve dhe kapaciteteve inspektuese dhe parandalimin e korrupsionit.

3. Risqe në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një fushë e rëndësishme, e cila kërcenohet nga risqe me ndikime negative për institucionin. Ato mund të hasen në aspekte dhe etapa të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore si emërimi, zgjedhja, transferimi, largimi i personelit nga puna, miratimi, zbatimi apo ndryshimi i strukturës organizative, i rregulloreve, kodeve të ndryshme etj. dhe që mund të çënojnë integritetin e institucionit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në mirëfunksionimin e tij.

Riorganizimi dhe përshtatja e vazhdueshme organizative janë procese të nevojshme në interes të rritjes së efikasitetit, por duke u bazuar në politika vizionare dhe nevoja konkrete, pasi ndonjëherë procese të tilla mund të krijojnë vetëm iluzionin e progresit dhe prodhojnë konfuzion, joefikasitet, pasiguri dhe demotivim tek punonjësit.

Pas analizës së bërë në lidhje me procesin e rekrutimit në strukturat e Ministrisë së Brendshme, punonjësit e aparatit si dhe një pjesë e funksioneve të disa institucioneve të varësisë, rekrutohen dhe administrohen bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për nëpunësin civil, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike. Roli i strukturave përkatëse të Ministrisë së Brendshme është i kufizuar në to.

Bazuar në ligjin nr 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, struktura dhe organika e Gardës së Republikës miratohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. Zinxhiri vendimmarrës, rekrutimi dhe procedurat e karrierës janë parashikuar me procedura të qarta, bazuar në ligj, për të shmangur raste të veçanta të riskut për abuzim. Në këtë linjë është ndjekur edhe metodologjia për hartimin e akteve nënligjore me qëllim përcaktimin e saktë të ndarjes së autoriteteve, përgjegjësisë, kompetencat dhe detyrat për sa i përket rekrutimit, menaxhimit të burimeve njerëzore, ecuria në karrierë etj. Vendimmarrja konsultohet brenda strukturave të Gardës dhe ka procedura standarde të miratuara që rregullojnë këtë aspekt.

Procesi i vendimmarrjes në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, është i mirëpërcaktuar në ligjin dhe në rregulloren e Gardës së Republikës. Fokusi kryesor dhe të gjitha masat që mund të ndërmerren për të minimizuar riskun në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore në Gardën e Republikës, do të përqëndrohen në procesin e gradimeve, promovimeve në karrierë, lëvizjeve në detyrë dhe në trajtimin e personelit me kurse trajnimi e kualifikimi. Për këtë qëllim dhe aspekte të tjera, Garda e Republikës do të hartojë në vijim një plan integriteti të veçantë në nivel institucioni.

Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, sikurse Garda e Republikës, funksionon sipas ligjit të posaçëm që rregullon dhe aspektet e rekurimit ecurisë në karrierë sipas një sistemi gradash, megjithatë aktet nënligjore kanë nevojë për rishikim për përmirësimin dhe rritjen e transparencës në rekrutim, ngritjen në detyrë, fitimin e gradave etj. Pavarësisht së shërbimi i MZSH-së është një shërbim i transferuar, roli i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në menaxhimin e burimeve njerëzore të këtij shërbimi është i një rëndësie të veçantë.

Për sa i përket institucioneve të tjera të varësisë së Ministrisë së Brendshme siç janë: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuues, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Shtëpia e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë, rekrutohen sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket këtyre strukturave, është vënë re se mungojnë procedurat dhe kriteret e mirëpërcaktuara ose ato nuk zbatohen me rigorozitet, duke mos respektuar parimet e konkurrueshmërisë dhe transparencës. Për këtë arsye me qëllim rritjen e transparencës, meritokracisë dhe llogaridhënies, është parashikuar rritja e kontrollit për realizimin e procedurave të brendshme mbi mënyrën e rekrutimit të punonjësve, për të sanksionuar emërimet e stafit me kontratë sipas Kodit të Punës, publikimin në faqen zyrtare të institucionit të vendeve vakante, kriterëve përzgjedhëse ashtu si dhe rezultateve, zbatimit korrekt të procedurave të parashikuara për rekrutimet dhe vlerësimi i dokumentacionit; hartimit të kërkesave specifike, aftësitë, cilësitë dhe kriteret që duhet të plotësojë dhe përgjegjësitë e vendit të shpallur të punës për çdo pozicion pune etj.

Mirëfunksionimi i administratës ka nevojë për përcaktimin e procedurave rigorozë dhe të qarta të promovimit në karrierë, vlerësimit dhe dhënies së gradave duke mos favorizuar individë për arsye preferenciale. Në këtë kuadër në zbatim të këtij Plani Integriteti janë parashikuar masat e mëposhtme:

- Respektimi rigoroz i procesit të gradimeve, i sanksionuar në rregulloret dhe në udhëzimet e miratuara për këtë qëllim;
- Njohja dhe bërja publike e çdo faze të procesit procesit, lista e konkurrentëve, vlerësimet e dosjeve, vlerësimet e performancës, vlerësimi i intervistës, i testeve të tjera fizike,

psikologjike dhe profesionale

- Bazë e plotë normative dhe procedura të hollësishme për zhvillimin e testimeve, intervistave, duke detajuar komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të çdonjërit prej tyre

4. Riske në fushën e menaxhimit financiar, të asetëve, projekteve dhe shërbimeve mbështetëse

Risqet në këtë fushë përfshijnë veprimtarinë e disa drejtorive apo strukturavë të Ministrisë së Brendshme. Në këtë grupim janë përfshirë risqet në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetit, risqet në fushën e shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të asetëve, risqet në fushën e menaxhimit të ankesave gjyqësore dhe administrative si dhe menaxhimin e projekteve.

Menaxhimi i financave publike është një fushë me rëndësi të veçantë që përfshin risqe të konsiderueshme potenciale të lidhura me korrupsionin. Kuadri ligjor dhe rregullator i legjislacionit financiar dhe praktikave për menaxhimin e financiar të aktiveve është në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Europian dhe është përcaktuar çdo përgjegjësi në mënyrë hierarkike. Delegimi funksional dhe financiar i vendimmarrjes brenda institucionit është i bazuar në rregullime ligjore dhe hierarkike mbi ekzekutimin e fondeve publike, kryejnë e pagesave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimet përkatëse

Megjithatë, në këtë kuadër, procesi riskohet në drejtim të planifikimit, shpërndarjes dhe zbatimit të buxhetit. Planifikimi i nevojave të shpenzimeve, pamundësia për të zhvilluar parashikime reale mund të çojë në probleme gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe realizimit të objektivave të çdo programi. Mosrakordimi ndërmjet planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit mund të krijojë mundësi të ndarjes së buxhetit në mënyrë jo efektive. Në ligjin e buxhetit dhe udhëzimet përkatëse është parashikuar mundësia e rialokimit të fondeve pas fazës së detajimit të buxhetit në rast se identifikohen probleme të paparashikuara gjatë vitit. Me rëndësi është që të gjithë nevojat për planifikim dhe rishikim të identifikohen qartë, të argumentohen dhe të korrigjohen.

Disa nga risqet e mundshme në këtë kontekst të identifikuar janë:

- Planifikimi dhe shpërndarja buxhetit jo sipas prioriteteve dhe nevojave reale;
- Mosraportimi në kohë mbi zbatimin e buxhetit;
- Mosrespektimi i afateve nga drejtuesit e programeve buxhetore në përgatitjen në kohë të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Ekzekutimi i shpenzimeve jo në përputhje me planifikimin;
- Kontrolli mbi saktësinë e dokumentacionit dhe të afateve të pagesave dhe paraqitja e dokumentacionit me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit në Degën e Thesarit.

Rritja e kontrollit të brendshëm dhe drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por dhe të shpenzimit të shumave të alokuara, përbëjnë masa thelbësore në drejtim të parandalimit dhe uljes së riskut të korrupsionit.

Nga analiza e kryer rezulton se, menaxhimi i asetëve është gjithashtu një fushë e ekspozuar ndaj riskut të korrupsionit dhe cënimit të integritetit. Në këtë aspekt mund të përmendim disa procese me risk të shtuar si:

- Vlerësimi i kërkesave për marrje/dhënie me qera të objekteve shtetërore;
- Vlerësimi i kërkesave për kalime kapitale.

Një risk i mundshëm paraqitet nga mospërditësimi i regjistrit të mjeteve të transportit në inventar dhe aktivëve për pronat/objektet në inventar, duke pasqyruar në vijimësi ndryshimet që ndodhin siç mund të jenë për ndryshim përgjegjësie administrimi, ndryshim pronësie, shitje e privatizim. Disa nga risqet që lidhen me menaxhimin e automjeteve në dispozicion të Ministrisë së Brendshme janë:

- Përdorimi i automjeteve në dispozicion të institucionit edhe nga funksionarë, të cilët mbështetur në Ligjin nr.169/2013, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10160” dhe Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 112, datë 18.04.2014, i ndryshuar për përmbushjen e detyrave funksionale, janë të përjashtuar nga ky përfitim;
- Përdorimi i automjeteve nga personeli në mungesë të dokumentacionit standard justifikues për disiplinimin e lëvizjes së automjeteve dhe qëllimin e shërbimit;
- Mungesa e transparencës sa i përket ndjekjes dhe dokumentimit të shpenzimeve për karburant, të automjeteve që janë në dispozicion të institucionit.

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe minimizimin e risqeve të identifikuar më sipër, në këtë Plan janë parashikuar masat si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i rregullave të qarta dhe specifike për përdorimin dhe shfrytëzimin e automjeteve;
- Pajisja me fletëinventarët e përditësuarë e çdo individi;
- Hartimi i zbatimi i procedurave për mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike, mirëmbajtjes;
- Procedura të detajuara për pajisjen e zyrave dhe të individëve në momentin e fillimit të punës nga ana e tyre dhe në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës;
- Kryerja e kontrolleve të vazhdueshme, periodike në inventarët nga strukturat përgjegjëse;
- Hartimi dhe zbatimi i procedurave të unifikuarë për mbajtjen si dhe raportimin e inventarëve në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi;

- Rritja e kontroleve nga MZSH qendrore dhe SHÇBA;
- Hartim dhe zbatim i procedurave standarde të punës.

Spektori përgjegjës për trajtimin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore mbron interesat e Ministrisë së Brendshme përballë ankesave gjyqësore dhe administrative. Ky sektor përfaqëson interesat e institucionit në proceset gjyqësore ku Ministria e Brendshme është palë, ndjek procedurat dhe kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të ankesave të mbërritura, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në atë ligjor, duke bashkëpunuar edhe me strukturat e tjera në ministri apo me institucionet e varësisë.

Faktorë risku në fushën e trajtimit të ankesave administrative dhe gjyqësore, nisur dhe nga impakti që ata mund të kenë në integritetin institucional mund të konsiderohen:

- Krijimi i një situatë më të favorshme ose lehtësira në gjyq bazuar në interesat privatë apo lidhjet personale;
- Lëshimi i informacioneve konfidenciale tek personat e paautorizuar dhe në gjykim.

Nga sa më sipër, rekomandohet kontroll i vazhdueshëm mbi veprimtarinë e sektorit, rritje e hetimeve të brendshme, rritje e njohurive mbi përdorimin e informacionit të klasifikuar, pajisje dhe njohje me kushtet e certifikatës së sigurisë. Masat e përcaktuara kanë për qëllim përgjigjen ndaj risqeve të identifikuar dhe synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe nivelit të ekspertizës, kontrollit dhe ndarjen më të mirë të përgjegjësisë.

5. Risqe në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit

Arkivimi, ruajtja e informacionit dhe administrimi i dokumentacionit është një fushë me rëndësi në veprimtarinë e Ministrisë së Brendshme, pasi përbën memorien institucionale të saj. Veprimtaria e sektorëve që punojnë në këtë fushë kryhet në përputhje të disa akteve ligjore: Ligji 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, *Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, Ligji Nr./8457 datë 11.02.1999 i ndryshuar, “Për informacionin e klasifikuar shtetëror” dhe aktet nënligjore, Ligji Nr.191/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, Ligji Nr.9887 datë.10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligji Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”. Megjithatë strukturat mbikëqyrëse duhet të sigurohen gjithmonë se klasifikimi i informacionit nuk përdoret si justifikim dhe as bëhet për t’iu shmangur apo fshehur kontrollit dhe se dokumentacioni administrohet në përputhje me parashikimet ligjore.

Disa nga risqet e identifikuar evidentuar në këtë fushë janë:

- Akses në informacionin e klasifikuar i personave të pacertifikuar;
- Lëshimi i informatave konfidenciale tek personat e paautorizuar;
- Dhënia e informacionit subjekteve që janë në proces verifikimi për pajisjen me Certifikatë Sigurimi Personeli (CSP);
- Kushte të papërshtatshme të sigurisë në ambientet ku administrohet dokumentacioni.

Në këtë kuadër, disa nga masat që do të ndërmerren synojnë zbatimin me rigorozitet të procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie për informacionin e klasifikuar për ato kategori të caktuara të punonjësve të strukturave të ndryshme të Ministrisë së Brendshme; rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar; identifikimin dhe përmirësimin e mënyrës së qarkullimit të informacionit etj.

6. Risqe në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët apo shërbimeve të tjera

Struktura të veçanta të Ministrisë së Brendshme që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët, mbartin një risk potencial të shtuar për cënimin e integritetit të punonjësit dhe të vetë institucionit.

Ofrimi i këtyre shërbimeve përmes kontaktit dhe shkëmbimit fizik, bart risqet e veta. Në këtë kuadër, do të vijojë puna e nisur për dixhitalizimin e shërbimeve përmes platformave online.

Për sa i përket shërbimeve të kontrollit të brendshëm, mosverifikimi në kohë dhe me profesionalizëm apo trajtimi në mënyrë preferenciale i ankesave të ardhura nga qytetarët përbëjnë gjithashtu fusha risku. Masat e identifikuar për këtë kategori risqesh lidhen me përmirësimin e procedurave, garantimin dhe shtimin e vazhdueshëm të shërbimeve online, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të ankesave, rritjen e kontrollit, konkretisht:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të ankesave
- Trajtimi i ankesave dhe përfundimi i trajtimit të tyre brenda afatit 30 ditor
- Referimi për hetim disiplinor të subjekteve që rezultojnë se kanë shkelur procedurat standarde të punës
- Referimi në Prokurori të rasteve të inicuar nga ankesat e qytetarëve

Mungesa e procedurave të qarta të punës që rregullojnë ndjekjen e çdo veprimtarie nga nëpunësit e gjendjes civile në bashki / njësi administrative dhe në prefektura, apo moszbatimi i tyre nga nëpunësit e gjendjes civile, përbën një fushë risku për shërbimin e gjendjes civile. Në këtë kontekst është parashikuar hartimi dhe zbatimi rigoroz i procedurave të plota që normojnë veprimtarinë e nëpunësve të Gjendjes Civile.

7. Risqe që lidhen me cënimin e etikës, paanshmërinë, dinjitetit, mbrojtjen e reputacionit dhe imazhit të institucionit

Një nga parimet dhe njëkohësisht dhe prioritet i Ministrisë së Brendshme është konsolidimi dhe promovimi i vazhdueshëm i vlerave të etikës profesionale të punonjësve të strukturave dhe institucioneve të varësisë. Vëmendja e shtuar dhe aplikimi i masave që synojnë trajtim dhe mundësi të barabarta, do të ulë riskun për korrupsion.

Në Planin e Veprimit, krahas risqeve specifike të lidhura me sjelljet dhe veprimet korruptive, janë identifikuar dhe risqe që çenojnë etikën, dinjitetin e punonjësve e që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në imazhin dhe reputacionin e institucionit. Të tillë si:

- Sjellje diskriminuese, përjashtuese apo favorizuese të të gjitha formave, sjellje ngacmuese, bullizuese, presion, komunikim joetik apo dhunë verbale në vendin e punës;
- Mungesë e përdorimit të mekanizmit të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Me qëllim parandalimin e veprimtarive dhe sjelljeve që dëmtojnë imazhin dhe integritetin e institucionit, ky Plan parashikon hartimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës së Ministrisë së Brendshme, duke përfshirë normimin e aspekteve të ndryshme si konflikti i interesit, pranimi dhe deklarimi i dhuratave, kontaktet me palët e treta, lobimet etj.

Trajnimi i punonjësve mbi kuadrin dhe mekanizmat ligjorë mbrojtës ndaj diskriminimit, respektimit të barazisë gjinore, sinjalizimit dhe mbrojtjes ligjore të sinjalizuesve, janë mekanizma të tjerë të parashikuar në këtë Plan.

Përmes realizimit të masave të identifikuar në këtë dokument, synohet ndryshimi i kulturës së “pranimit në heshtje”, rritja e ndërgjegjësimit në fushën e mbrojtjes së integritetit fizik dhe moral të punonjësit në ambientet e punës si dhe ulja e numrit të rasteve të evidentuara në të cilat është shkelur etika, cënuar dinjiteti njerëzor apo cënuar imazhi i institucionit.

VI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq koordinimin dhe bashkërendimin e strukturave dhe institucioneve për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit 2022-2024. Në këtë kuadër do të angazhohen të gjithë strukturat e Ministrisë së Brendshme, pjesë e aparatit të saj dhe institucionet e varësisë.

Zbatimi i Plani të Integritetit do t'i nënshtrohet një procesi periodik monitorimi dhe vlerësimi. Ky proces do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve/koordinatorëve që do të caktohen në të gjitha strukturat përgjegjëse.

Në kuadër të monitorimit, koordinatorët do të përgatitin dhe përcjellin raportimet vjetore, të cilat do shërbejnë për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuar në Planin e Veprimit, si dhe efektivitetin e masave.

Pika e kontaktit për çështjet e antikorrupsionit në Ministrinë e Brendshme, do të koordinojë mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e raportimeve që do të përcillen nga strukturat dhe institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse dhe do të përgatisë raportin e integruar vjetor.

Gjithashtu do të organizojë takime me institucionet e përfshira, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë për të diskutuar gjetjet dhe adresuar problematikat, nën drejtimin e Zëvendësministrit përgjigjës për çështjet e antikorrupsionit dhe integritetit, në cilësinë dhe të përfaqësuesit të Ministrisë së Brendshme në Komitetin Koordinator Kundër Korrupsionit.

Bazuar në vlerësimin sasior dhe cilësor të arritjeve, rrethanave, risqeve dhe eksperiencave të mëparshme, problematikave të ndeshura në implementim, do të formulohen rekomandime për ndryshime në dokument, duke synuar kështu përmirësimin e vazhdueshëm të politikave institucionale në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit.

Pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Planit të Integritetit 2022-2024, do të përgatitet një raport përfundimtar vlerësimi, ku do të analizohen dhe vlerësohen rezultatet në aspektet e përmbushjes së objektivave, masave të ndërmarra, burimeve të investuara, efektivitetit dhe të ndikimit si dhe do të identifikohen nevojat për vijueshmërinë e masave në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe ndërtimit të integritetit në strukturat dhe institucionet e Ministrisë së Brendshme.

VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Korrupsioni është fenomen dinamik që merr forma të ndryshme, duke i'u përshatur rrethanave, roleve, ndryshimeve ligjore apo teknologjike. Për këtë, risku i korrupsionit është prezent në të gjithë sektorët. Korrupsioni është gjithashtu një ingranazh i lidhur drejtpërdrejtë me krimin e organizuar dhe terrorizmin, duke u shndërruar në kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë publike. Në këtë kuadër, lufta ndaj korrupsionit duhet të jetë e pakompromis, e vazhdueshme dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e tij si fenomen.

Një përgjigje strategjike ndaj korrupsionit do të ishte rritja dhe promovimi i integritetit, si dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies në sektorët të vlerësuar si më vulnerabël, duke ulur ndjeshëm mundësitë për abuzim dhe korrupsion.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Brendshme është një dokument strategjik i hartuar bazuar në analizën e fushave më me risk ndaj korrupsionit dhe cënimit të integritetit. Plani i Veprimit për implementimin e tij përfshin rregulla, masa dhe aktivitete për parandalimin e veprimeve korruptive, si dhe shmangien dhe uljen e rreziqeve që çenojnë integritetin e punonjësve dhe të institucionit. Në dokument përcaktohen strukturat përgjegjëse, afatet kohore, treguesit për mënyrën e matjes së realizimit të masës dhe objektivat e synuara për secilën prej tyre.

Pas miratimit të dokumentit, të gjithë strukturat dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme do të njihen me të dhe do të organizohen për të marrë masat përkatëse për zbatimin e detyrimeve të tyre institucionale. Të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me këtë plan, vizionin dhe me metodologjinë e përcaktuar, brenda vitit 2022 do të përgatisin planet e tyre të integritetit, ashtu si është parashikuar në Planin e Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023, për forcimin e qasjes parandaluese - ndëshkuese - ndërgjegjësuere kundër korrupsionit.